



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.592/ 4 prot.

Datë 06 /03/2026

V E N D I M
Nr. 358/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06 /03 /2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Keta Elite” SH.P.K, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,245,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,245,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Ankimues: Operatori ekonomik “KetaElite” sh.p.k, *NIPT M46915401B, me adresë: Shetitorja Qyteti i Ri, nd.23; H. 6; zona kadastrale 8611; Bulqize .*

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, me adresë: Rruga Baki Gjebrea , Berat

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nen kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

1.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19-02-2026 , është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimitme nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,245,000.00 Lekë Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

II.2. Në datën 25.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, me nr. 592/2026 prot., datë 25.02. 2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6361, protokolluar me datë 25.02.2026, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 154 prot., me datë 02.03.2026, protokolluar me tonën nr. 592/1 prot., me datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

...[Konkluzioni: Bazuar mbi Nenin 114 pika 3/b, e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike” i ndryshuar, dhe Nenit 102 pika 1/b, dhe pika 3 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vendosi si më poshtë:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së Operatorit ekonomik “KetaElite” shpk, me Nipt M46915401B, Adresa: Shetitorja Qyteti I Ri, Nd 23, H 6, Zk 8611, Bulqizë, Administrator Z. Erjon Keta, sipas arsyetimit më lart”.].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Keta Elite sh.p.k për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1. 2. Me shkresën me nr. 154 prot., me datë 02.03.2026, protokolluar me tonën nr. 592/1 prot., me datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor infomon me vendimin mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht atë si në vijim :

...[Konkluzioni: Bazuar mbi Nenin 114 pika 3/b, e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike” i ndryshuar, dhe Nenit 102 pika 1/b, dhe pika 3 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vendosi si më poshtë:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së Operatorit ekonomik “KetaElite” shpk, me Nipt M46915401B, Adresa: Shetitorja Qyteti I Ri, Nd 23, H 6, Zk 8611, Bulqizë, Administrator Z. Erjon Keta, sipas arsyetimit më lart”.].

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e

autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 154 prot., me datë 02.03.2026, protokolluar me tonën nr. 592/1 prot., me datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor infomon Komisionin e Prokurimit Publik, për trajtimin e ankesës, si dhe ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

...[Konkluzioni: Bazuar mbi Nenin 114 pika 3/b, e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike” i ndryshuar, dhe Nenit 102 pika 1/b, dhe pika 3 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik Komisioni i Shqyrtimit të ankesave vendosi si më poshtë:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së Operatorit ekonomik “KetaElite” shpk, me Nipt M46915401B, Adresa: Shetitorja Qyteti I Ri, Nd 23, H 6, Zk 8611, Bulqizë, Administrator Z. Erjon Keta, sipas arsyetimit më lart”.].

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “Keta Elite ” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Keta Elite ” SHPK , me arsyen se :

...ANKESE 3, Ne piken 2.3.4 te seksionit “Kritere te Vecanta te Kualifikimit” ne Dokumentet e Tenderit, AK ka parashikuar:

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionët), ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit (pranë magazinës së Agjencisë së Shërbimeve Publike, Rr. Baki Gjebrea, Rajoni Nr. 1), për zërat me nr si më poshtë:

- 1.Kabull ?4*6 mm
2. Kabull ?4*4 mm
3. Kabull ?4*2.5 mm
- 4.Kabull ?2*2.5mm
5. Kabull ?2*1.5mm
10. Llampë led 40ë, 3000kelvin
- 11.Llampë led 40 ë , 4200 kelvin
- 14.Llampë sodium 150ë te bardha 6500kelvin
28. Ndriçues 50 ë, 4000 K
30. Ndriçues 100ë, 7000 kelvin
31. Llampë Gu 10, 2800 Kelvin
33. Pllakë PCB 50ë, 3000 kelvin
36. Ndriçues 100ë 4000 Kelvin, me mekanizëm levizje 41.Ndriçues 50 ë, 6500 Kelvin

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.

SQAROJME:

Duke qene se kjo eshte nje kontrate per mallra, gjen rregullim ne Ne VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 40, Kërkesa te veçanta per kontratat e mallrave.

Ne piken 6 te ketij neni citojme:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
 - a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
 - b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
 - c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që

vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

E kuptojmë që AK mund të kërkojë mostra për produktet, por në rastin e një procedure të hapur të thjeshtuar, mendojmë se kjo kërkesë është e ekzagjeruar (neni 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm).

AK për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike mund të kërkojë edhe kataloge të produkteve, jo vetëm mostra. Sqarojmë se artikujt janë të paketuara në kuti, dhe AK as nuk arrin ta shohë produktin. Nuk e kuptojmë si do ta vlerësojë AK se mostra plotëson specifikimet teknike të kërkuara në procedure, përderisa produkti është i mbyllur në kuti dhe nuk duket.

Paraqitja e fotografive apo katalogëve teknikë në vend të mostrave, për produktet e kriterit 2.3.4 e bën kriterin më gjithëpërfshirës, dhe lehtëson pozitat e OE sidomos biznesit të vogël dhe të mesëm, sic është kompania jone. Gjithashtu këto mostra kanë një vlerë financiare të konsiderueshme, që perseri rëndon pozitat e biznesit të vogël dhe të mesëm, sic është kompania jone.

Gjithashtu Agjencia e Prokurimit Publik, në Rekomandimin nr 787, datë 23.01.2026, pika 11, thotë: AK duhet të argumentojë teknikisht vendosjen si kriter kualifikimi paraqitjen e mostrave, duke përcaktuar ndër të tjera edhe se cilat nga specifikimet teknike janë të nevojshme për t'u verifikuar nëpërmjet mostrave.

Në proces-verbalin e argumentimit të kriterëve nuk gjejmë asnjë sqarim se cilin specifikim konkretisht do të verifikojë AK nga mostrat, për sa kohë që ato janë të mbyllura në kuti.

KERKESE 3

AK të modifikojë Dokumentet e Tenderit në pikën 2.3.4 të seksionit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” duke hequr kërkesën për mostra, dhe duke pranuar paraqitjen e fotografive apo katalogëve teknikë skedave teknike të këtyre produkteve në vend të mostrave, sepse fotografitë apo katalogët teknikë konsiderohen nga ligji (sic kemi cituar më lart) ekuivalente me mostrat dhe japin shumë më tepër informacion për produktin sesa kutitë e mbyllura.

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.4 të Shtojcës 8 “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka parashikuar si në vijim,

“2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **mostrat (kampionët)**, ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit (pranë magazinës së Agjencisë së Shërbimeve Publike, Rr. Baki Gjebrea, Rajoni Nr. 1), për zërat me nr si më poshtë:

1. Kabull Ø4*6 mm
2. Kabull Ø4*4 mm
3. Kabull Ø4*2.5 mm
4. Kabull Ø2*2.5mm
5. Kabull Ø2*1.5mm
10. Lampa led 40ë, 3000kelvin
11. Lampa led 40 ë , 4200 kelvin
14. Lampa sodium 150ë të bardha 6500kelvin
28. Ndriçues 50 ë, 4000 K
30. Ndriçues 100ë, 7000 kelvin

- 31. Lampa Gu 10, 2800 Kelvin**
33. Pllakë PCB 50ë, 3000 kelvin
36. Ndricues 100ë 4000 Kelvin, me mekanizmem levizje
41.Ndricues 50 ë, 6500 Kelvin

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Mosparaqitja e mostrave ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s’kualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.3. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b)

gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.6. Në neni 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..”. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.7. Lidhur me pretendimin se operatorit ekonomik ankimes me arsyen se :... *[AK te modifikoje Dokumentet e Tenderit ne piken 2.3.4 te seksionit “Kritere te Vecanta te Kualifikimit” duke hequr kerkesen per mostra, dhe duke pranuar paraqitjen e fotografive apo katalogëve teknikë skedave teknike te ketyre produkteve ne vend te mostrave, sepse fotografitë apo katalogët teknikë konsiderohen nga ligji (sic kemi cituar me lart) ekuivalente me mostrat dhe japin shume me teper informacion per produktin sesa kutite e mbyllura...]*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve,

parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. Operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me dokumentet e tenderit për sa kohë operatorët ekonomikë i kanë pranuar ato, dhe mospërmbushja qoftë edhe e një kriteri apo specifikimi teknik përbën shkak skualifikimi nga autoriteti kontraktor. Për sa më sipër është në të drejtën e autoritetit kontraktor vendosja e kriterëve lidhur kjo dhe me objektin e prokurimit, kjo në mënyrë për të paraparë dhe verifikuar përmbushjen e objektit të prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Keta Elite ” SHPK , me arsyen se : ...

ANKESE 4

Ne shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, AK per produktet 10, 11, 12, 28, 30, 36, 41, ka kerkuar te kene te shenuar ne ambalazh nje periudhe garancie 1 vit, apo 2 vjet, apo 3 vjet, apo 5 vjet.

SQAROJME:

Ambalazhi i produkteve behet nga prodhuesit e tyre. Ne jemi tregetare dhe nuk i detyrojme dot prodhuesit, qe gjenden ne shtete te ndryshme te botes, te vendosin ne ambalazh cfaredo lloj shenimi per garancine, dhe aq me teper saktesisht shenim me periudhen qe kerkon AK.

Kjo kerkese eshte e ekzagjeruar dhe shkon pertej mundesive tona si operatore, por edhe pertej percaktimeve ligjore. Ne kete rast AK do te vleresoje ambalazhin e prodhuesit i cili nuk eshte fare ofertues ne kete procedure, dhe kjo gje bie ne kundërshtim me ligjin.

Garancia per produktet mbahet nga OE, pasi marrëdhënia e AK eshte me OE, jo me prodhuesin e produkteve. AK nuk ka asnje lidhje me prodhuesin, nese produkti ka nje difekt, AK do ti drejtohet OE, jo prodhuesit.

Ne proces-verbalin e argumentimit nuk gjejme asnje sqarim lidhur me kete kerkese.

KERKESE 4

AK te modifikojë specifikimet lidhur me garancine per produktet 10, 11, 12, 28, 30, 36, 41, dhe te kerkoje qe kjo garanci te mbahet nga OE. Te hiqet kerkesa per garanci te shenuar ne ambalazh.

III.3.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” te dokumentave standarte te tenderit specifikimet teknike për artikujt si në vijim:

Shtojca6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

10	Llampa led 40ë, 3000 kelvin	• Jetëgjatësia: 25.000 Hrs • Fuqia: 40 ë • Tensioni: 175-250V • Tipi: LED • Lloji i ndriçimit: 3000 K • Lloji i portollambës: E27 • Garancia ne ambalazh 2 (dy) vjecare • Përmasat e llambës 118mm x 190mm • Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.
11	Llampa led 40ë, 4200 Kelvin	• Klasi i energjisë: A • Jetëgjatësia: 20.000 Hrs • Fuqia: 40 ë • Tensioni: 165-265V • Tipi: LED • Lloji i ndriçimit: 4200 K • Lloji i portollambës: E27 • Garancia ne ambalazh 2 (dy) vjecare • Përmasat e llambës 100mm x 190mm

		<i>Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.</i>
12	Llampa led 18ë, 3000 kelvin	• Klasi i energjisë: A+ • Jetëgjatësia: 25.000 Hrs • Fuqia: 18 ë • Tensioni: 175-250V • Tipi: LED • Lloji i ndriçimit: 3000 K, 1600 lumen • Përmasat e llambës 70 mm x 128 mm • Garancia ne ambalazh 2 (dy) vjecare • Lloji i portollambës: E27 <i>Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.</i>
28	Ndricues 50 ë, 4000 kelvin	• Fuqia: 50ë • Tensioni: 220-240V • Shkalla e mbrojtjes: IP65 • Garancia ne ambalazh 3 (tre) vjecare), 6500 lumen • Permasat e ndricuesity 173mm x 410 mm • Materiali: baker/plastik • Ndriçimi: 4000K <i>Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.</i>
30	Ndriçues 100ë,7000 kelvin	• Fuqia: 100 ë • Klasi energjise A++ • Tensioni: 85-265V • Eifenca ne pune me shume se 90% • Shkalla e mbrojtjes: IP66 • Materiali: baker/plastik • Ndriçimi: 7000K • Gryka e ndriçuesit Ø 40 mm • Garancia ne ambalazh1 (një) vjecare • Te kete specifikuar indeksin e ngjyrave te larte (high CRI) <i>Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.</i>
36	Ndriçues 100ë, 4000 k me mekanizem levizje	• Fuqia: 100ë • Tensioni: 220-240 V • Shkalla e mbrojtjes: IP65 • 9400 lumen • Me mekanizem levizje te gradueshem deri ne 180 grad • Jetgjatesia 30.000 hrs • Te kete te stampuar ne ambalazh 5 vite garanci • Materiali: alumin/plastik • Ndriçimi: 4000K <i>Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente.</i> <i>Indeksi I ngjyrave I percaktuar CRI me e madhe ose = 80.</i> <i>Gryka e ndricimit Ø 60 mm</i>
41	Ndriçus 50 ë, 6500 K	• Fuqia: 50ë • Klasi energjisë A++ • Tensioni: 85-265 V • Efiçensa në punë me shume se 90%

		• Shkalla e mbrojtjes: IP66 • Materiali: alumin/plastik • Ndriçimi: 6500K (I bardhë), 100 lumen ë. • Origina e produktit te jete per CEose ekuivalente. • Gryka e ndriçuesit Ø 40 mm • Te kete specifikuar indeksin e ngjyrave te larte (high CRI) • Garancia ne ambalazh1 (një) vjecare
--	--	---

III.3.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KetaElite” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, sa i përket specifikimeve, ...AK te modifikoje specifikimet lidhur me garancine per produktet 10, 11, 12, 28, 30, 36, 41, dhe te kerkoje qe kjo garanci te mbahet nga OE. Te hiqet kerkesa per garanci te shenuar ne ambalazh ...Komisioni vëren se,

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.3.5 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.6 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët*

ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.7. Në nenin 40, pika 3 dhe 6 të VKM nr.285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislationin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kërkesës AK të modifikojë specifikimet lidhur me *garancine per produktet 10, 11, 12, 28, 30, 36, 41, dhe te kerkoje qe kjo garanci te mbahet nga OE*. Te hiqet kërkesa per garanci te shenuar ne ambalazh., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin, nëse kërkesat janë në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese, zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke ofruar produkte që përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e entit prokurues. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit, me anë të dorëzimit të mostrave të mallrave objekt - prokurimi. KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor *“garancia ne ambalazh të artikullit”* janë kërkesa të ekzagjeruara dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - ankimi, duke i hequr këto kërkesa të përcaktuara të Shtojcës 6, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për si në vijim : ...[ANKESE 5

Specifikimet teknike te produkteve nuk jane hartuar ne zbatim te kuadrit ligjor ne fuqi, jane te paqarta dhe te paplota, ne kundërshtim me nenin 36 te LPP i ndryshuar, ku percaktohet se

“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor” dhe ne kundërshtim me nenin 40 te Rregullave te Prokurimit Publik, ku thuhet se “specifikimet teknike, duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar”:

Per disa produkte specifikimet e vendosura jane te paqarta dhe te pamjaftueshme, nuk arrijme te kuptojme se cfare produkti kerkon AK.

RENDISIM ME POSHTE PROBLEMATIKAT ME SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Produkti 31:

31	Llampa Gu 10, 2800 Kelvin	?	Fuqia: 50 ë
?	Tensioni: 220-240V		
?	Shkalla e mbrojtjes: IP66		
?	Ndriçimi: 2800K		
?	Jetgjatsia 2000 hr		
?	Lloji I portollambës Gu 10		
?	Klasi C		

Origjina e produktit te jete per CEose ekuivalente

1. Për një llampë GU10, fuqia reale e LED-it nuk mund të jetë 50 Ë, sepse kjo është një llampë me përmasa shumë të vogla dhe teknikisht e pamundur të përmbajë një LED me atë fuqi.

Ju lutem na thoni nese fuqia e deklaruar 50 Ë i referohet ekuivalentit të ndriçimit, pasi ndriçimi i prodhuar është i barasvlershëm me një llampë halogjene 50 Ë?

Produktet 33, 38:

33 Pllakë PCB 50 ë,3000kelvin ? Fuqia: 50ë

? Input 100-277 V. Output 18-36 V.

? Shkalla e mbrojtjes: IP67

? Materiali: alumin/plastik

? Ndriçimi: 3000K

? Permasat e pllakes 120mmx120mm

? Origina e produktit te jete per CEose ekuivalente.

38 Pllakë PCB 50 ë,4000kelvin ? Fuqia: 50ë

? Input 100-277V, Output 18-36 V

? Shkalla e mbrojtjes: IP67

? Materiali: alumin/plastik

? Permasat 145mmx 130 mm

? Ndriçimi: 4000K

? Origina e produktit te jete per CEose ekuivalente.

1. Cfare eshte nje pllake PCB, cfare kuptimi kane iniciallet PCB dhe ju lutem perkthejini ne shqip kete specifikim.

2. Ku perdoren keto pllaka, cfare funksioni kryejne, per cfare sherbejne keto pllaka, jane pjese e ndonje pajisje me te madhe? Ne cilat pajisje vendosen keto pllaka?

3. Lutemi publikoni foto ilustruese te produkteve qe te kuptojme se per cfare behet fjale.

4. Per me teper produkti 33 eshte kerkuar te paraqitet si moster, dhe ne nuk kuptojme cfare kerkoni dhe cfare mostre tju sjellim.

Produkti 35:

35 Shtyllë ndriçimi (formë cilindrike, ngjyrë kafe, materiali çeliki I zinkuar 127.90, lyerja bojë elektrostatische 200 gradë cel, lartësia 780 cm, karkasa alumin i andonizuar, IP 66.

1. Ju lutem sqaroni cfare kuptimi kane shifrat 127.90 ne specifikimet e produktit.

2. Keni kerkuar qe ne te njejten kohe shtylla te jete ngjyre kafe, dhe materiali çelik i zinkuar dhe karkasa alumin. Ju lutem saktësoni specifikimet teknike si e kerkoni shtyllen e ndritcimit.

3. Lutemi publikoni nje foto ilustruese te produktit qe te kuptojme se per cfare behet fjale.

Produkti 39:

39 Led Poëer suply (furnizues ledi/driver), 60 ë ? Fuqia: 60 ë

? Tensioni I punës: 100-240V

- ? *Shkalla e mbrojtjes: IP67*
- ? *Materiali: baker/plastik*
- ? *Origina e produktit te jete per CEose ekuivalente.*
- ? *Out put: 12-24 volt*

1. *Ju lutem perktheni ne shqip emertimin e produktit pasi gjuha e procedures eshte shqip, dhe duke lene emertimet ne anglisht krijohen keqkuptime dhe keqinterpretime.*
2. *Ju lutem na sqaroni cfare kerkoni: kerkoni furnizues per led apo kerkoni driver? Sepse produkti nuk mund te jete njekohesisht edhe furnizues per led, edhe driver. Zgjidhni cilin kerkoni.*
3. *Keni kerkuar Out put: 12-24 volt. Ju lutem saktsoni cilin out put kerkoni, 12 volt apo 24 volt, sepse produkti nuk ka sesi te jete njekohesisht edhe 12 volt edhe 24 volt.*
4. *Lutemi publikoni nje foto ilustruese te produktit qe te kuptojme se per cfare behet fjale.*

III.4.1 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb kanë të bëjnë me paqartësi mbi përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontrakt. KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka dhënë sqarime përse është kërkuar në ankesë. Akoma më tej Komisioni thekson se, referuar nenit 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”, ligji për prokurimin publik i ka dhënë të drejtën operatorëve ekonomikë të kërkojnë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. Lidhur me paqartësitë dhe saqrimet e operatorit ekonomik ankimues “KetaElite” SHPK, sa më sipër arsyetuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë në mënyrë shteruese operatorin ekonomik ankimues për paqartësinë e tij, lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sa më sipër dhe këto sqarime duhet të publikohen në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KetaElite sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar“ me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,245,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KetaElite sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,245,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas vendimit të KSHA dhe KPP si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KetaElite” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

